

**RIZBULIMI I PAKTHYESHËM I FAKTORIT SHQIPTAR  
NË MESDHE E EUROPË**

*Noel Malcolm (Agents of Empire: Knights, Corsairs, Jesuits and Spies in the Sixteenth-Century Mediterranean World, Penguin Books, 2015) fut në tregun botëror akademik veprën që tashmë ka njohur dhjetëra recensione më të shkëlqyera duke i ruzbuluar paktheyshëm shqiptarët në arenën e madhe historike të kohës*

Shqiptarët mu në mes të përplasjes globale të kohës - pak a shumë – kë-shtu mund të përmblihet motoja e librit të fundit të historianit të njohur Noel Malcom “Agjentët e perandrive...”.

Dy familje shqiptare e shumë perandori dhe forca politike të kohës, rajone, e mbretëri, që nga Perandoria Otomane, Mbretëria e Spanjës, Perandoria Habsburgase, Vatikani, Venediku, Dubrovniku, Mbretëria Polake, Moldavia etj. Janë familjet fisnike Bruti e Bruni që i lidh origjina, martesat, statusi dhe fati në një kohë të turbulluar kur lojaliteti e sovraniteti janë në një përpëlitje historike mu në arenën që përfshinë shqiptarët, duke iu dhënë atyre rol shumë më të madh në histori se sa që shqiptarët, me historiografinë tyre, apo të tjerët, kanë arritur ndonjëherë të spikatin e të shpjegojnë.

Të dyja familjet janë nga Ulqini i Arbërisë venedikase, që një shekull e gjysmë së bashku me Shkodrën dhe pjesën bregdetare në rripin e detit

kishte qenë qendër e zhvillimeve të rëndësishme gjeopolitike në tërë Mesdheun. Brutit dhe Brunët detyrohen, pas një rezistence ku kishin luajtur rol prominent, të shpërnguleshin në hapësirat venedikase dhe në vuajtje të hatashme, pasi që Ulqini bie nën otomanët, të penetrojnë në rolet nga më të ndryshmet duke qenë protagonistë të diplomacisë dragomane, spiunazhit dhe kundërspiunazhit duke bërë shërbime (Bartolomeo Bruti) që nga të qenët pjesë e diplomacisë venedikase, deri në shërbim të mbretërisë së Spanjës, duke involvuar vetë mbretin, letërkëmbimet me mbretëreshën britanike, titullin fisnik të Polonisë, dorën e djathtë të Princit të Moldavisë, statusin fisnik në Koprin e sotëm të Sllovenisë, ku u vendosën këto familje. Krejt këto Bruti me vëllezër dhe nipa, që shkojnë në disa gjenerata, arriti t'i bënte edhe falë lidhjes shqiptare. Ai, duke qëndruar një kohë të gjatë në Stamboll, ku kishte lidhje farefisnore me kryevezirin Sinan Pasha, arriti të ketë qasje deri aty ku asnjë nga perën-

dimorët as që kishte ëndërruar. Rivalitetet e lobeve ballkanike, shqiptarë e sllavë në kryeqendrën e Perandorisë Otomane, që silleshin rreth Mehmet pasha Sokolloviqit (të vëllait të kryepeshkopit serb Makarie) dhe Sinan Pashës nga Luma, i cili e ka ngritur Kaçanikun në Kosovë, duke qenë i vetmi zyrtar që 5 herë ka qenë kryeministër dhe 3 herë kryeushtarak i forcës më të madhe të kohës, e sjell edhe më shumë, në mënyrë plastike e intelegjente, vlerësimin e Noel Malcomit për shqiptarët në përpëlajtjet e mëdha të kohës në Evropë.

Shto kësaj edhe rolin e Brunëve, nga të cilët del kryqtari fisnik, i vetmi në rendin e Shën Gjonit të Jerusalemit në Maltë, si dhe oficerit të forcave të papatit në luftën e njohur të Avinjonit në Francë, tërë tablosë i jep një zbulim të faktorit shqiptar atëkohë në Mesdhe e në Evropë, në fundin e mesjetës dhe në lindjen e kohës moderne.

Malcomi ngre në një sintezë më të lartësuar punimet emblematike të Braudelit mbi Mesdheun dhe të Halil Inalcikut mbi balancën e forcave gjeopolitike të kohës: Perandorisë Osmane dhe forcat katolike e protestante të Evropës.

Malcomi edhe njëherë, duke sjellë një kryevepër me stil brilant në tregun botëror akademik, që tashmë ka njohur dhjetëra recensione të shkëlqyera - i rizbulon pakthyeshmë shqiptarët në arenën e madhe historike të kohës.

**Ylber HYSA**